



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINA SUVA REKA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA



ZYRA E PROKURIMIT

Nr. 06/2021

Nr. Protokolli: 09/2021

Për:	"XONI " SH.P.K., Brigada 123, 23000, Suharekë
Kopje:	z.Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës
Nga:	Afrim BYTYQI, u.d. Shef i Prokurimit
Lënda:	VENDIM
Datë:	21.01.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesave për Rishqyrtim të derguar në Platforme Elektronike të datës 19.01.2021, të parashtruar nga Operatorët Ekonomik: "XONI " SH.P.K., Brigada 123, 23000, Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Transportimi i Masës Drusore të Konfiskuar- Ri-tender" me Nr. të Prokurimi: 624-20-8485-2-3-6&624-20-113-236 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim të datave: 19.01.2021 të parashtruar nga Operatorët Ekonomik: "XONI " SH.P.K., Brigada 123, 23000, Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Transportimi i Masës Drusore të Konfiskuar- Ri-tender" me Nr. të Prokurimi: 624-20-8485-2-3-6&624-20-113-236, kundër Njoftim për Vendimin e AK –së, të datës 19.01.2021 të publikuar në platformën elektronike.

Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK të publikuar me datë: 18.01.2021 .

2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Ar sy e t i m

Autoriteti Kontraktues, Komuna Suhareke me datë 19.01.2021, ka pranuar kërkesa për ri-shqyrtim të aktivitetit të prokurimit **Transportimi i Masës Drusore të Konfiskuar- Ri-tender** me Nr. të Prokurimi: **624-20-8485-2-3-6&624-20-113-236**, kundër Njoftim per Vendimin e AK –së, të datës 18.01.2021 të publikuar në platformen elektronike.

Ak- Suharekë, në bazë të kërkesë së njësisë së kërkesës ka inicuar aktivitetin e Prokurimit, sipas specifikimeve teknike ne dosje te tenderit, te derguar nga njesia e kërkesës dhe sipas vleres së parashikuar, të evidentuara në Deklaraten e Disponueshmerisë së Fondeve, ku ju si ofertues, në oferten tuaj keni tejkaluar vleren e parashikuar të fondeve, dhe sit ë tillë ka ardhur në njoftimin për Anulimin e këtij Aktivitetit, konform dispozitave ligjore të LPP-së dhe RrOUPP.

Të pretendimi juaj se në këtë vitë është rritur sasia e specifikimit teknik dhe është ulur vlere e parashikuar e fondeve, ju gjatë njoftimit për kontratë nuk keni shfrytëzuar të drejten e sqarimeve shtesë sipas kohës së paraparë, dhe se gjatë kësaj periudhe nuk kemi pasur asnje ankesë lidhur me këtë çështje.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, ankesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.
Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

u.d. Shef i Prokurimit
Arif BYTYQI

